

Nr/Bt. 588/20  
Datë/Datum. 28/07/2020

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr <sup>1</sup> iprokurimit	622-20-3121-5-1-1
Nr i brendshëm	622-20-062-511

Sa i përket tenderit për: Ndërtimi i rrugës Serbicë e poshtme - Serbicë e epërmenë Prizren

## ANKESË

### 1. Identifikimi i ankuesit\*

NPN "RENELUAL TAHIRI" shpk

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga e Jonit 92/2, Prizren

(Adresa)

Prizren

20 000

(Vendi) (Kodi postar)

044/128112

N/A

(Numri Telefonit) (Numri i Faks-it)

Yll Hoxha

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

renelual\_tahiri@hotmail.com

(Adresa elektronike)

28.07.2020

<sup>1</sup> Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

*\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtoj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:*

Njoftimi për Kontratë me dt. 23.06.2020

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave me dt. 03.08.2020

Kërkesa për rishqyrtim: 27.07.2020

Vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim: 27.07.2020

## 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po

☐

Jo

☐

**5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet**

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:*

Po ☐

Jo ☐

**6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve**

*A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po ☐

Jo ☐

**7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 27 i LPP-së

Neni 18.9 i RRUOPP

Neni 26.3.4 i RRUOPP



*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Të nderuar AK-ja me dt. 23.06.2020 ka publikuar tenderin me titull "Ndërtimi i rrugës Serbicë e poshtme - Serbicë e epërme në Prizren".

Në dosje të tenderit tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale në nenin 9.1&9.2 të FDT-kërkesa 2.AK-ja ka kërkuar: *"Në kuadër të stafit duhet të caktohet menaxheri I projektit I cili duhet të jetë inxhinier I diplomuar I ndërtimtarisë drejtimi rrugorë ose master me jo më pak se 5 vite përvojë pune në profesion - Të ketë menaxhuar së paku një projekte të natyrës së kontratës".*

Ju sqarojmë se kjo kërkesë është diskriminuese për OE që mendojnë të marrin pjesë në këtë aktivitet të prokurimit dhe ua mbyll dyert e ofertimit shumë kompanive pasi që kërkesa e lartpërmendur është shumë kufizuese, ndërsa dihet që AK-ja në shumicën e rasteve ka kërkuar inxhinier të diplomuar drejtimi konstruktiv dhe gjithashtu vlen të theksohet se inxhinier *të drejtimit rrugor ose master* siç e ka kërkuar AK-ja, ka shumë pak në vendin tonë, prandaj me këtë kërkesë hapur shihet dhe kuptohet se në këtë aktivitet të prokurimit po favorizohen kompani të caktuara.

Ne kërkojmë që të detyrohet AK-ja që të ndryshon kërkesën në lidhje me inxhinierin e diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi rrugor ose master, dhe kërkojmë që të vendoset si kërkesë inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv apo drejtim tjetër, ashtu siç AK-ja ka kërkuar edhe në aktivitetet tjera të mëhershme të prokurimit ku kemi pasur të bëjmë më punë të ngjashme dhe ashtu siç e kërkojnë edhe autoritetet tjera kontraktuese. Nëse do të kërkohej inxhinier i ndërtimtarisë p.sh drejtimi konstruktiv apo ndonjë drejtim tjetër absolutisht nuk do të ndikonte negativisht në proces të punës sepse çdo herë pothuajse kërkohet nga autoritetet tjera e po ashtu edhe nga AK-ja inxhinier i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv, prandaj është e çuditshme se nga i lindi kjo ide AK-së që të kërkojë inxhinier të ndërtimtarisë drejtimi rrugor apo master.

Ju sqarojmë edhe një herë se kërkesa e lartcekur është shumë diskriminuese pasi që ju kufizon mundësinë e ofertimit shumë kompanive, pasi që siç e cekëm më lartë inxhinierin që AK-ja e ka kërkuar në vendin tonë janë shumë të pakta në numër dhe po favorizohen kompani të caktuara.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe kundërshtimet tona që u cekën më lartë rezulton se autoriteti kontraktues nuk e ka përpiluar dosjen e tenderit në harmoni me nenin 27 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e ka pasur parasysh as nenin 18.9 të RRUOPP ku shkruan qartë që *"Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve.*

Pra duke u bazuar në të gjitha faktet që u cekën më lartë shihet tendenca e AK-së për dhënien e kontratës



OE të caktuar, pasi që kërkesa e lartpërmendur i përshtatet kompanive të caktuara.

Ne me dt. 27.07.2020 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjigje faktike dhe ligjore në pretendimin tonë ankimor, duke mos e shqyrtuar fare pretendimin tonë ankimor.

Ndërsa në nenin 26.3 të RRUOPP shkruan qartë që *“Të gjitha kërkesat minimale për kualifikim do të jenë drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë”*. Prandaj kërkesa e kontestuar nga ne nuk është proporcionale me objektin e kontratës, sepse shumë kontrata të kësaj natyre janë përfunduar pa këtë inxhinier dhe mund të përfundohen pa problem.

Pra me këtë kërkesë dhe dëshmi të kërkuar mundësia është shumë e madhe dhe pothuajse e pashmangshme e dëmtimit të buxhetit, sepse kompanitë e caktuara (favorizuese) mund të ofertojnë me çmime shumë më të larta dhe eventalisht të nënshkruajnë kontratë, pasi që kërkesa e lartpërmendur është favorizuese për kompani të caktuara prandaj edhe mundësia e manipulimit me çmime është shumë e madhe.

Duke u bazuar në kërkesën e lartpërmendur që është diskriminuese-favorizuese, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet as qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë: *Qëllimi i këtij ligji është të sigurojmë në mënyrë më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike sidhetë gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.*

Kërkesa e lartcekur bie në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1, 3, 4 dhe 6 të LPP-së, sepse në këta paragraf parashihet qartë që operatorët ekonomik nuk mund të diskriminohen në asnjë mënyrë dhe në asnjë variant. Prandaj kërkesa të cilën e kontestuar më lartë duhet larguar/ndryshuar për të pasur një aktivitet të prokurimit normal dhe për të mos u diskriminuar/favorizuar kompanitë e caktuara.

Madje në paragrafin 6 të nenit të lartcekur (7) pika (i) shkruan që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; pjesëmarrjen samë të gjerët mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit

Kërkesa që u kundërshtua më lartë, është shumë favorizuese/diskriminuese dhe njëkohësisht ua mbyll dyert e ofertimit pothuajse shumë kompanive dhe kjo kërkesë është në kundërshtim edhe me nenin 26.4 të Rregullave dhe Udhëzuesit operativ për prokurim publik, sepse aty shkruan qartë se *“Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do të kushtojë rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formulojë kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike”*.

Pra autoriteti kontraktues në vend se të ketë parasysh edhe zhvillimin e operatorëve ekonomik të rinjë, përveç se nuk e kamarr parasysh këtë dispozitë, AK-ja i ka diskriminuar hapur edhe

operatorët ekonomik tjerë më shumë përvojë në këtë fushë dhe që kanë realizuar shumë kontrata të mëdha milionëshe edhe pa këtë inxhinier të ndërtimtarisë drejtimi rrugor

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

## VENDIM

**APROVOHET**, si e bazuar ankesa e OE “NPN “RENELUAL TAHIRI”

**DETYROHET** autoriteti kontraktues që të ndryshoj kërkesën, që u cek më lartë nga ana jonë dhe pastaj të veprohet konform nenit 53 të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

### 9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Dëmet materiale akoma nuk janë llogaritur sepse jemi në fazën e njoftimit për kontratë dhe fazën para ofertuese.

### 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.